REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

PROCESVERBAL

MBLEDHJA E TETË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE (KVA) PËR GRANTIN E BAZUAR NË PERFORMANCË (GBP) 2026

28 TETOR 2026

Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve (KVA) — Sekretariati Teknik: AMVV

agjencia për mbështetjen amvv e vetëqeverisjes vendore

Hapja e Mbledhjes

Znj. Olta Caca hapi mbledhjen e fundit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve (KVA), e cila kishte për qëllim **vlerësimin përfundimtar për 3 treguesit e fundit të GBP 2026,** i cili përmbyll mbledhjen e fundit të vlerësimit të 16 treguesve në fushat përkatëse:

- Paketa emergjencës për viktimat e dhunës e planifikuar në buxhet 2026;
- Plani Vendor Social;
- Shtimi i shërbimeve Sociale.

Vlerësimi përfundimtar i treguesit Paketa e Emergjencës për Viktimat e Dhunës

Sekretariati Teknik deklarojë se për këtë tregues, nuk ka administruar asnjë ankesë nga bashkitë dhe në këto kushte, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit të Përbashkët, me përfundimin e afatit të ankimimit pa raste të paraqitura, vlerësimi paraprak mbetet i pandryshuar dhe konfirmohet me vlerësimin përfundimtar.

Anëtarët e Komisionit ndoqën mbledhjen nëpërmjet pjesëmarrjes online dhe dakortësuan vlerësimin përfundimtarë, i cili do të përcjellet në mënyrë elektronike.

I. **Vlerësimi përfundimtar** për paketën e emergjencës për viktimat e dhunës

SHTOJCA 1		
PAKETA E EMERGJENCËS PËR VIKTIMAT E DHUNËS E PLANIFIKUAR NË BUXHET 2026		
Nr.	**Bashkia**	**Kualifikohet për kriterin e cilësisë në përputhje me Udhëzimin**
1	Berat	Po
2	Delvinë	Po
3	Devoll	Po
4	Dimal	Po
5	Divjakë	Po
6	Dropull	Po
7	Durrës	Po
8	Elbasan	Po
9	Fier	Po
10	Fushë-Arrëz	Po
11	Gjirokastër	Po
12	Himarë	Jo
13	Kamëz	Po
14	Klos	Po

15	Korçë	Po
16	Lezhë	Po
17	Librazhd	Po
18	Lushnje	Po
19	Malësi e Madhe	Jo
20	Maliq	Po
21	Mat	Po
22	Patos	Po
23	Pogradec	Po
24	Poliçan	Po
25	Prrenjas	Po
26	Pustec	Po
27	Roskovec	Po
28	Selenicë	Po
29	Shijak	Po
30	Shkodër	Po
31	Skrapar	Po
32	Tepelenë	Po
33	Tiranë	Jo

Vlerësimi përfundimtar për Planin Social Vendor

Sekretariati Teknik bëri me dije se, pas përfundimit të afatit të ankimit për treguesin **Plani Social Vendor**, nuk ka administruar asnjë ankesë nga bashkitë.

Në vijim, ***znj. Nertila Topulli,*** përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ngriti një problematikë lidhur me procesin e vlerësimit të kritereve të cilësisë së Planeve Sociale Vendore. Ajo argumentoi se, duke qenë se Sekretariati Teknik administron dokumentacionin dhe kryen verifikimin e aplikimeve, nuk është e nevojshme që KVA të shqyrtojë edhe planet e bashkive që nuk përmbushin kriteret mbi domumentacionin dhe skualifikohen nga verifikimi që kryen Sekretariati Teknik.

Sekretariati Teknik sqaroi se verifikimi paraprak ka karakter formal dhe administrativ, duke u kufizuar në kontrollin e përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e parashikuara në aneksin 2 të Udhëzimit të Përbashkët. Informacioni i paraqitur pranë KVA-së është përmbledhës dhe pasqyron gjendjen e dokumentacionit të administruar, ndërsa vlerësimi i përmbajtjes dhe cilësisë së Planeve Sociale Vendore sipas procedurave të Aneksit 3 të Udhëzimit, kryhet në përputhje me detyrat dhe kompetencat e përcaktuara.

Gjatë diskutimeve, u propozua që në udhëzuesin e ardhshëm të GBP-së të përcaktohen kriteret mbi aplikimin, duke i lejuar bashkive kualifikimin, **vetëm një herë për të njëjtin plan vendor**, me synim zgjerimin e përfitimit dhe shpërndarjen më gjithëpërfshirëse të mbështetjes financiare. Gjithashtu, u sugjerua që dokumentacioni mbështetës i aplikimeve t'i përcillet Komisionit vetëm për bashkitë që kalojnë

fazën e parë të verifikimit nga Sekretariati Teknik, me qëllim përqendrimin e procesit të vlerësimit tek aplikimet që kualifikohen në fazën e parë.

Në përfundim, u vijua me procesin e vlerësimit përfundimtar për treguesin **Plani Social Vendor**, ku u përcaktua që anëtarët e KVA të përcjellin vlerësimin përkatës në mënyrë elektronike.

II. Vlerësimi përfundimtar për planin social vendor

SHTOJCA 2		
PLANI VENDOR SOCIAL		
Nr.	**Bashkia**	**Kualifikohet për kriterin e cilësisë në përputhje me Udhëzimin**
1	Dimal	Po
2	Fier	Po
3	Finiq	Jo
4	Gjirokastër	Po
5	Himare	Jo
6	Këlcyrë	Jo
7	Kukës	Po
8	Librazhd	Jo
9	Memaliaj	Po
10	Peqin	Jo
11	Rrogozhinë	Jo
12	Shkodër	Po
13	Tiranë	Po
14	Tropojë	Jo

Vlerësimi përfundimtar për treguesin shtimi i shërbimeve sociale

Në vijim, ***znj. Olta Caca*** evidentoi rastet e dy bashkive që kishin paraqitur ankesa lidhur me vlerësimin e treguesit të shtimit të shërbimit social, konkretisht, Bashkia Prrenjas dhe Dimal.

Me shqyrtimin e rasteve të paraqitura, ***Znj.Xhilda Papajani***, përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sqaroi dhe argumentoi duke u mbështur në ligj dhe aktet nënligjore arsyen përse ankesat e këtyre bashkive nuk qëndrojnë.

Sipas **neneve 3 dhe 8 të ligjit nr. 121/2016**, **"Për shërbimet e kujdesit shoqëror", të ndryshuar,** shërbimet e kujdesit shoqëror përbëjnë një sistem të organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të ofruara nga profesionistë të fushave përkatëse, në komunitet, institucione ose familje. Neni 8 përcakton tipologjitë e këtyre shërbimeve, përfshirë shërbimet komunitare, rezidenciale, të specializuara dhe forma të tjera të kujdesit shoqëror. Për rrjedhojë, klasifikimi i një mase si shërbim i ri social kërkon identifikimin e një **shërbimi konkret, mënyrës së organizimit dhe ofrimit të tij, dhe jo vetëm të qëllimit social apo kategorisë së përfituesve.**

Gjithashtu, në përputhje me **VKM-në nr. 518, datë 4.9.2018**, pikat 1 dhe 2, si dhe dispozitat pasuese, përcaktohen tipologjitë, kriteret dhe procedurat për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial. **Kompensimi monetar i transportit nuk identifikohet si tipologji** më vete shërbimi apo formë e veçantë përfitimi brenda këtij vendimi. Gjithashtu, sipas standardeve përkatëse, transporti mund të konsiderohet element mbështetës vetëm kur është pjesë e organizimit dhe ofrimit të një shërbimi social të identifikueshëm. Në rastin konkret, masat e propozuara kufizohen në mbështetje financiare, pa dokumentuar ngritjen apo organizimin e shërbimeve të reja sociale.

Nga ana tjetër, **VKM-ja nr. 224, datë 9.4.2024**, në pikat 4, 5 dhe 6, parashikon identifikimin e shërbimeve ekzistuese, analizimin e nevojave të paplotësuara dhe planifikimin e shërbimeve sociale, duke përcaktuar aktivitetet, njësitë zbatuese, afatet, treguesit, bazën ligjore dhe financimin përkatës. Megjithëse masat janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak dhe janë parashikuar në Fondin Social të buxhetit vendor, **miratimi dhe planifikimi buxhetor i pagesave nuk provojnë, në vetvete, ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror**. Për më tepër, mbështetja e transportit për personat që trajtohen me dializë synon lehtësimin e aksesit në një shërbim shëndetësor dhe nuk dokumentohet si pjesë e një shërbimi të organizuar të kujdesit shoqëror.

Sa i takon ankesës së bashkisë Dimal, nga dokumentacioni rezulton se qendra funksionon që prej vitit 2024, duke ofruar shërbime komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në nevojë social-ekonomike dhe viktimat e dhunës në familje, me financim nga Fondi Social dhe Bashkia Dimal. Gjatë vitit 2025, kapacitetet e saj janë zgjeruar edhe me shtimin e figurës së psikologut.

Në mbështetje të pretendimit, Bashkia ka paraqitur **VKB-në nr. 51, datë 14.10.2024**, për zgjerimin e shërbimeve të qendrës, sipas aktivitetit 3.1.1 të Planit Social Vendor 2024–2026, urdhrat e emërimit të dy kujdestareve, datë 14.01.2025 dhe 10.02.2025, si dhe Planin Social Vendor 2026–2028, ku parashikohet financimi i pagave dhe sigurimeve shoqërore për këto pozicione gjatë viteve 2025–2026.

Komisioni vlerëson se dokumentacioni dëshmon planifikimin dhe angazhimin për zgjerimin e kapaciteteve njerëzore të një shërbimi ekzistues, por **shtimi i dy pozicioneve të punës nuk provon, në vetvete, ngritjen e dy shërbimeve të reja sociale**. Në dokumentacion nuk identifikohen qartë shërbimet konkrete, përmbajtja, mënyra e organizimit dhe përkatësia e tyre në **dy tipologji të reja shërbimesh sociale**.

Në përfundim të diskutimeve me anëtarët, KVA vlerësoi se masat e propozuara nga Bashkia Prrenjas përbëjnë forma të mbështetjes financiare për dy kategori përfituesish, por **nuk dokumentojnë ngritjen e dy shërbimeve të reja sociale**, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Po ashtu, për Bashkinë Dimal, KVA vlerësoi se dokumentacioni dëshmon shtimin e planifikuar të personelit dhe zgjerimin e kapaciteteve të një shërbimi ekzistues, por jo ngritjen e dy shërbimeve të reja sociale gjatë periudhës 1 janar 2025 – 30 qershor 2026. **Për rrjedhojë, Komisioni propozoi mospranimin e ankesave të të dyja bashkive, për shkak të mosdokumentimit të përmbushjes së kriterit përkatës** dhe konfirmimin e vlerësimit paraprak i cili do të përcillet në mënyrë elektronike.

III. Vlerësimi përfundimtar për treguesin shtimi i shërbimeve sociale

SHTOJCA 3

SHTIMI SHËRBIMIT SOCIAL SIPAS POPULLSISË

Nr.	Bashkia	Kategorizimi i bashkive sipas popullsisë	Kualifikohet për kriterin e cilësisë në përputhje me Udhëzimin
1	Përmet	deri në 10000	Po
2	Dropull	deri në 10000	Po
3	Pukë	deri në 10000	Jo
4	Pustec	deri në 10000	Po
5	Selenicë	deri në 10000	Po
6	Himarë	deri në 10000	Po
7	Fushë-Arrëz	deri në 10000	Jo
8	Delvinë	deri në 10000	Po
9	Konispol	deri në 10000	Po
10	Poliçan	deri në 10000	Jo
11	Mirditë	10000-50000	Jo
12	Gjirokastër	10000-50000	Po
13	Kukës	10000-50000	Jo
14	Skrapar	10000-50000	Po
15	Devoll	10000-50000	Po
16	Finiq	10000-50000	Po
17	Mat	10000-50000	Po
18	Pogradec	10000-50000	Po
19	Klos	10000-50000	Jo
20	Roskovec	10000-50000	Po
21	Cërrik	10000-50000	Jo
22	Tropojë	10000-50000	Jo
23	Maliq	10000-50000	Po
24	Kavajë	10000-50000	Jo
25	Librazhd	10000-50000	Jo
26	Gramsh	10000-50000	Po
27	Vau i Dejës	10000-50000	Jo
28	Divjakë	10000-50000	Po
29	Shijak	10000-50000	Jo
30	Prrenjas	10000-50000	Jo
31	Malësi e Madhe	10000-50000	Po

32	Kurbin	10000-50000	Jo
33	Dimal	10000-50000	Jo
33	Patos	10000-50000	Jo
33	Vorë	10000-50000	Po
33	Berat	50000-150000	Jo
33	Shkodër	50000-150000	Jo
33	Korçë	50000-150000	Po
33	Lezhë	50000-150000	Jo
33	Elbasan	50000-150000	Po
33	Fier	50000-150000	Jo
33	Kamëz	50000-150000	Po
33	Lushnje	50000-150000	Po
33	Vlorë	50000-150000	Po
33	Durrës	50000-150000	Jo
33	Tiranë	Mbi 150000	Jo

ANËTARËT E KVA - GBP 2026				
Mbledhja e tetë e KVA-së				
Nr.	**Institucioni**	**Emër**	**Mbiemër**	**Pozicioni**
1	MB	Indri	Dyrmishi	Kryetar
2	MF	Fran	Brahimi	Anëtar
3	MSHMS	Etleva	Sheshi	Anëtar
5	MSHMS	Xhenson	Çela	Anëtar
5	MSHMS	Nertila	Topulli	Anëtar
6	MSHMS	Xhilda	Papajani	Anëtar